



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 17.2.2025

Nr: 105

Ora: 12:00

**VENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË DEKLARATËS TIP PËR ZGJEDHËSIT ME BANIM JASHTË  
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS  
11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronja "dh", e 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe vendimit nr. 11, datë 1.11.2024 të Komisionit Rregullator "Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit", të ndryshuar,

**VENDOS:**

1. Miratimin e përmbajtjes së deklaratës tip për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

## DEKLARATË TIP

Sot, më datë \_\_.\_\_.\_\_\_\_, unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, i biri/ e  
bija e \_\_\_\_\_, i/e datëlindjes \_\_.\_\_.\_\_\_\_, mbajtës/e i/e  
letërnjoftimit/pasaportës të lëshuar nga shteti \_\_\_\_\_ me numër personal  
\_\_\_\_\_, banues në \_\_\_\_\_,

me përgjegjësi të plotë,

### DEKLAROJ:

se aplikuesi z/zj. \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ (lidhja me deklaruuesin mbajtës i  
adresës), mbajtës/e i/e letërnjoftimit/pasaportës të lëshuar nga shteti shqiptar me numër personal  
\_\_\_\_\_, është banues në të njëjtën adresë si unë, në  
\_\_\_\_\_ (shteti, kodi postar, qyteti, emërtes e rrugës, numrin e  
banesës, si dhe elemente të tjera të adresës (nëse ka), dhe jeton në këtë adresë që nga  
\_\_\_\_\_ (data e fillimit të banimit në këtë adresë).

Deklaroj se të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe të plota dhe se jam i vetëdijshëm për pasojat  
ligjore në rast të deklarimit të rremë dhe keqpërdorimit të adresës që zotëroj.

### Deklaruesi

\_\_\_\_\_

(emër, mbiemër, firmë)